



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.09

Prishtinë, më 01.04.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Shukrije Bytyqi, Teuta Haxhiu dhe Mufera Sinik.

Munguan: Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi dhe Jelena Bontiç.

Pjesëmarrës të tjerë: Blendina Krasniqi-UNDP (praktikante), Petrit Prenaj- Tribuna, Isuf Koci-KKTK, Sanije Berisha-OSBE, Salie Gajtani-Koha Ditore.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.03.2015;
3. Shqyrtimi i listës së kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.03.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 18.03.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i listës së kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Nait Hasani, tha se Ministria e Kulturës e ka sjellur listën e kandidatëve edhe në Kuvend është një numër i aplikantëve dhe gjithësej janë 19 kandidat për tu shqyrtuar, prej të cilëve shtatë duhet të përzgjedhen për seancën e Kuvendit, në bazë të ligjit pesë duhet të jenë shqiptar, një nga minoriteti serb dhe një nga minoritetet tjera. Nëse ka ndonjë mospajtim mund të kërkojmë nga Ministria që ta plotësojë këtë listë. Në vazhdim tha se secili ti marrë me vete dokumentacionin e të gjithë kandidatëve, ti vlerësojë dhe në mbledhjen e ardhshme ti shqyrtojmë dhe procedojmë për Kuvend.

Salih Morina, tha se për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore kërkohet të jenë njerëz profesionist, andaj pasi që nuk janë të gjithë anëtarët e Komisionit prezent është mirë që dokumentacionin e kandidatëve ta marrim me vete dhe javën e ardhshme të vendoset dhe theksoi se është mirë që të informohet edhe Ministria e Kulturës për listën e kandidatëve.

Komisioni njëzëri propozoi që lista me dokumentacionin e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, të shqyrtohet dhe të analizohet nga anëtarët e Komisionit ndërsa në mbledhjen e radhës të bëhet përzgjedhja e tyre.

4. Të ndryshme

Teuta Haxhiu, pyeti se deri ku ka shkuar çështja e debatit për arsimin në Preshevë.

Nait Hasani, tha se për çështjen e debatit për arsimin në Preshevë e kemi përcjell kërkesën në Kryesi të Kuvendit dhe ende nuk kemi marrë përgjigje.

Teuta Haxhiu, pyeti se a duhet ne ta njoftojmë Kuvendin me raportin nga vizita në Preshevë.

Nait Hasani, tha se ne e kemi përgaditur raportin dhe duhet të shqyrtohet, të nënshkruhet dhe Kryesia të njoftohet me punën tonë.

Shukrije Bytyqi, tha se duhet të shqyrtohet çështja e Agjencionit të Akreditimit dhe të ftohet përsëri kryetarja e agjencionit sepse kemi vërejtje në Akreditimin e të gjitha Kolegjeve.

Nait Hasani, tha se nga ISPE-ja ka shumë vërejtje dhe ankesa dhe duhet të fokusohemi në Ligjin për Arsimin e Lartë për ta zgjedhur këtë çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani